




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: Migjen Husaj B.I.
Emri Tregtar: N.SH."RTV DIASPORA"
Numri Unik Identifikues: 811547994
Pronar: Migjen Husaj
OSHMA: TV Diaspora
Adresa: Rr/Muharem Fejza nr. 291,
Kompleksi banesorë Princesha, Prishtinë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele me transmetim përmes operatoreve të shpërndarjes TV Diaspora, me seli në Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.
2. TV Diaspora është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-vizuel i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim të programeve televizive përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë. KPM, me vendimin e datës 9 gusht 2013, ka bërë lëshimin e licencës së TV Diaspora për një afat prej shtatë (10) vitesh, ndërsa më datën 9 gusht 2023, ka skaduar afati i licencës së TV Diaspora.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe TV Diaspora, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 11 maj 2023, TV Diaspora ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.

Arsyetim

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*

6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar TV Diasporën lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
7. Komisioni konstaton se, TV Diaspora përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio-vizuele me transmetim përmes operatorin) në lokacionin për të cilin është licencuar.
8. Komisioni konstaton se TV Diaspora ka bërë një marrëveshje me përbaruesin privat për shlyerjen e obligimet financiare, brenda afatit një vjeçar, të përcaktuar me vendim të Komisionit të KPM-së. TV Diaspora ka kryer pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
9. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në ueb faqen e kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së TV Diaspora.
10. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, audiovizuel TV Diaspora të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së TV Diaspora është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së TV Diaspora i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut.

Vendim

12. Komisionit merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës së TV Diaspora në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audiovizuele me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes.
13. Licenca e TV Diaspora do të jetë e vlefshme për një afat prej dhjetë vitesh (10) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 9 gusht 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së TV Diaspora do të mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.10.2023

Data